VENDIM
Nr.653, datë 28.7.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.172, DATË 10.3.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË SHËRBIMIT TË ANIJEVE DETARE DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË "ANIJET E SHËRBIMIT DETAR" SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, pikat 1 e 3 dhe nenit 23, pika 3, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.172, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të disa shërbimeve detare".

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të shërbimeve detare, është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Shërbimet që do të jepen me koncesion janë:

a) Kryerja e shërbimit të rimorkimit të anijeve gjatë operacionit të futjes e daljes nëpër porte, akostimit në kalatat e porteve;

b) Shërbimi i transportit të grupeve të praktikës së autoriteteve portuale gjatë marrjes së praktikave të lira në rada;

c) Transportimi i ekuipazheve të anijeve nga rada në port dhe anasjelltas;

ç) Operacionet e ngarkim-shkarkimit të peshave të rënda në det.".

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha